

VENDIM
Nr.515, datë 6.7.2011

**PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR TË SIPËRFAQES NË NGASTRAT E EKONOMISË
PYJORE “ZALLI SHKUMBIN”, ELBASAN, QË DO TË PËRDORET NGA SHOQËRIA
KONCESIONARE “WET-T” SHPK, PËR NDËRTIMIN E HEC-IT TOPÇIAS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 17 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja në ngastrat 22/a, 22/b dhe 22/c, të ekonomisë pyjore “Zalli Shkumbin”, në teritorrin e komunës Shirgjan, Elbasan, gjithsej 8.7 (tetë pikë shtatë) ha, që do të përdoret nga shoqëria koncesionare “W.E.T-T” sh.p.k., për ndërtimin e nyjes hidroenergjetike, Topçias, të hiqet nga fondi pyjor dhe Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave, sipas tabelës 1 dhe hartës përkatëse që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pasi të përcaktohen në terren dhe në hartë kufijtë e rinj të fondit pyjor kombëtar, që rezultojnë nga heqja e sipërfaqes së këtyre ngastrave sipas pikës 1 të këtij vendimi, bën çrregjistrimin e saj nga kategoria “Tokë e zënë, tokë me bimësi pyjore” dhe e regjistron në sipërfaqe truall për ndërtimin e HEC-it Topçias sipas kondicioneve të sheshit të ndërtimit, të parashtruara në aneksin 1 dhe planimetrinë bashkëlidhur, në përputhje me vendimin nr.1353, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”.

3. “W.E.T-T” sh.p.k., të paguajë për sipërfaqen që hiqet nga fondi pyjor dhe kullësor, si pasojë e ushtrimit të veprimtarive të parashikuara, tarifat e llogaritura sipas lidhjes 4 të vendimit nr.391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria koncesionare “W.E.T-T” sh.p.k., brenda 3 (tre) viteve, me fondet e veta, të pyllëzojë 4 (katër) ha me pyje në ngastrat e përcaktuara nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor. Lloji i drurëve, që do të mbillen, dhe grafiku i mbjelljeve caktohen nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor, e cila ndjek mbjelljet deri në marrjen në dorëzim me procesverbal të sipërfaqes së pyllëzuar, sipas marrëveshjes që do të lidhë me kërkuesin.

5. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha